



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
SEKTORI JURIDIK

Shijak, më 13.02.2018

NJOFTIM

Bashkia Shijak, Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 753 , datë 13.12.2017 “Kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017-2018”;

NJOFTON për paraqitje dokumentacioni:

Nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kriterëve, si më poshtë vijon:

Sipas kriterit ekonomik:

1. Nxënësit e arsimit parauniversitar që vazhdojnë studimet në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre e që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Nxënësit e arsimit parauniversitar që banojnë në zonat rurale, që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km, që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe akomodohen në konvikte publike

Sipas rezultateve të arritura:

3.
1. Nxënësit e arsimit profesional që kanë mbaruar vitin shkollor pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta).

Jashtë kriterit ekonomik:

1. Nxënës që kanë përfituar statusin e jetimit;
2. Nxënës që kanë humbur kujdestarinë prindërore, me vendim gjykate të formës së prerë; c) Nxënës që gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik;
3. Nxënës që gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë;
4. Nxënës fëmijë të personave që gëzojnë statusin e invalidit e që përfitojnë pension invaliditeti dhe nuk kanë të ardhura të tjera;

5. Nxënës të komunitetit rom dhe egjiptian që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional;
6. Nxënës që janë identifikuar dhe trajtuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;
7. Nxënës, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrë

Sipas degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm, nxënësit që ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional:

1. Në drejtimet mësimore: bujqësi, veterinari, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit.
2. Me vendbanim të përhershëm në zonat verilindore dhe juglindore të vendit: Dibër, Bulqizë, Mat, Kukës, Has, Tropojë, Pukë, Mirditë, Malësi e Madhe, Librazhd, Gramsh, Kolonjë, Përmet, Skrapar dhe Tepelenë

Studentët nuk përfitojnë bursë apo humbasin të drejtën e përfitimit në rast se:

1. Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj, kur:
2. Janë ndarë nga trugu familjar;
3. Familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;
4. Shpallen ngelës apo përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese.

Dokumentacioni i cili duhet te paraqitet në zyrat përkatëse është:

1. Kërkesë më shkrim nga kryefamiljari;
2. Vërtetim banor lagjeje;
3. Certifikatë familjare;
4. Veërtetim i shkollës përkatëse;
5. Vërtetim nga Zyra Vendore e Pasurive të Paluajtshme, Durrës;
6. Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve ,Durrës;
7. Vërtetim nga Zyra e punës (sipas rastit)
8. Vërtetim nga Zyra e Ndhmës ekonomike, në Njësinë e Qeverisjes Vendore (sipas rastit)
9. Vërtetim nga ISSH,DURRËS për përfitim nga KMCP i nxënësit osë i një familjari (sipas rastit)
10. Vërtetim për përfitim me tokë bujqësore sipas Ligjit 7501 datë 19.07.1991

Shënim : Dokumentat të jenë të tre muajve të fundit dhe dorëzimi i tyre bëhet pranë Zyrës së

Afati përfundimtar i pranimit të dokumentacionit është data 21.02.2018

Juriste A. Mehmeti

**KRYETARI
ARDIAN KOKOMANI**

